



Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Dragash
Opština Dragaš
Municipality Dragas

Në bazë të nenit 12.paragrafi 12.2., pika d dhe nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03.L-040 për Vetëqeverisje Lokale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës“ nr.28 i dt.15.06.2008), nenit 10 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtëshme Komunale (Ligji br.04/L-144), nenit 20 paragrafi 3 e nënparagrafi 3.2 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtëshme të Komunës dhe nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 të dt.11.09.2008, Kërkesës së KEDS-it (Distrikti Prizren) 06 Nr.353/1-1163 të dt.01.02.2017, Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.28.03.2017, miraton këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTËSHME TË KOMUNËS KOMPANISË KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE (KEDS)

- I. **MIRATOHET** Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtëshme të Komunës në shfrytëzim Kompanisë së Kosovës për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), pa konkurs,
- II. Sipas pikës I të këtij Vendimi, në shfrytëzim jepet kjo paluajtshmëri:
 - pjesa e parc.kadastrale 70604011-02755-1, ZK Globoçica I, me sipërfaqe 9 m/2,
- III. Qëllimi i dhënies së tokës ndërtimore komunale, të përmendur në pikën II të këtij Vendimi është vendosja e e trafos elektro-energjetike të stacionit TSB-250 KVA,
- IV. Toka e paluajtëshme e Komunës së Dragashit, e përcaktuar në pikën II të këtij Vendimi, jepet në afat shfrytëzimi prej 15 viteve,
- V. Toka ndërtimore komunale e Komunës, e përcaktuar në pikën II të këtij Vendimi, jepet në shfrytëzim me kompenzim. Kompenzimi vjetor të cilin do të pagaun KEDS-i për shfrytëzim të pronës është 108,00 euro dhe atë në bazë të Rregullores për Kushtet dhe Kriteret për Dhënien me Qira të Tokës Ndërtimore Komunale 01 Nr.06-125/1 itë dt.04.08.2009,
- VI. Të drejtat dhe obligimet do të rregullohen me Kontratë të veçantë në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të autorizuar të shfrytëzimit të pronës,
- VII. Për zbatimin e këtij Vedimi do të përkujdesen: Kryetari i Komunës dhe organi kompetent i shfrytëzimit të pronës,
- VIII. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokolimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe pas publikimit në gjuhën zyrtare në web-faqen e Komunës.

I dërgohet:

- KEDS-it (Prishtinë, Prizren dhe Dragash),
- Drejtoratit për Urbanizëm, Gjeodezi, Kataster dhe Mbrojtje të Mjedisit-Dragash,
- MAPL-së (Zyrës Ligjore)-Prishtinë, dhe
- Arkivit

01 Nr.060/01-4036/4
Dt.28.03.2017
D r a g a s h

KUVENDI KOMUNAL DRAGASH



Kryesuesi
Shaban Shabani